



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 8451/2 Prot

Fier më, 28/08/2025

### PROCES VERBAL

Mbledhja e Këshillit të Bashkisë datë 28.08.2025. Sot në sallën e mbledhjeve ora 11:00. Të pranishëm në mbledhje 32 këshilltarë.

Znj. Antoneta Çunaj

Përshëndetje të nderuar këshilltarë ! Fillojmë mbledhjen e këshillit bashkiak, meqënëse sekretari ka verifikuar që është krijuar kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes.

#### Pika e parë e rendit të ditës.

Miratimi i rendit të ditës si më poshtë:

1. Miratimi i Rendit të Ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë **31.07.2025**.
3. **Projekt – vendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 %, për muajin Korrik 2025”.
4. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve te qeverisjes vendore, Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”.
5. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e kërkesës së shoqërisë “Veko” sh.p.k. për dhënien e të drejtës së kalimit “Për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e linjës nëntokësore së transmetimit të energjisë elektrike” në pronat e Bashkisë Fier”
6. **Projekt vendim:** “Për dhënien e miratimit për zgjatjen e afatit të kontratave të qirasë nr. 2686 rep. nr. 925 kol. dt. 01.12.2016 dhe kontrata nr. 2824 rep. nr. 954 kol. dt. 15.12.2016, të lidhura ndërmjet Bashkisë Fier dhe subjekteve qiradhënës Arben Haxhi Behaj, Sokrat Dhimitër Jovani dhe Fejzo Beqir Fejzo” të qiramarrjes së pasurisë nr. 8/2 dhe 8/4 zk. 8531 e llojit “truall” me sipërfaqje totale 3 466 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “Kryengritja e Fierit”.

7. **Projekt – vendim:** “Për heqjen detyrimeve të propambetura të cilat janë të pasqyruara në kontabilitetin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike për arsy se mungon dokumentacioni për të bërë të mundur ekzekutimin e tyre”
  8. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e subvencionit të qirasë për familjen e pastrehë , që kërkon të përfitojë nga subvencionimi i qirasë në tregun e lirë dhe nuk ka të ardhura për të përballuar vlerën e qirasë”.
- 
9. Informacion Këshillit :”Mbi vlerat e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të propozuara dhe vlerësuara nga komisionet përkatëse gjatë kryerjes së inventarizimit 2024, të aparatit të Bashkisë Fier si dhe të disa Njësive Shpenzuese në varësi të Bashkisë Fier.

Znj. Antoneta Çunaj

Materialet besoj se ju kanë ardhur të gjithëvë në mënyrë elektronike. Kështu që hedhim ne votim rendin e ditës . Kush është dakort ?

Pro 32 vota.

Kundra s`ka.

Abstenim s`ka.

Miratohet.

#### **Pika e dytë e rendit të ditës.**

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së këshillit të datës 31.07.2025

Znj. Antoneta Çunaj

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 31.07.2025. Materiali u është dorëzuar të gjitha forcave politike, është firmosur prej tyre. Kush është dakort ?

Pro 31 vota.

Kundra s`ka.

Abstenim 1 votë .

Miratohet.

#### **Pika e tretë e rendit të ditës**

Projekt vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 %,për muajin Korrik 2025”

Znj. Antoneta Çunaj



Kush e do fjalën nga administrata?

Znj.Suela Prifti

Përshëndetje! Nga fondi i kushtëzuar i ndihmës ekonomike 6% për muajin korrik përfitojnë gjithsej 37(tridhjetë e shtatë) familje me një shumë 180825 lekë. Gjithsej kanë dalë 3(tre) familje për tu verifikuar m.q.s kanë kohë që përfitojnë këtë ndihmë dhe janë futur 4(katër) familje të tjera.Familjet që kanë dalë janë: Lindita Zijaj, Florika Malo dhe Marinela Derka.Janë futur këto familje: Ornella Shosha, Natasha Gjeci, Erion Kumanaku dhe Lena Sinanaj. Nga verifikimi që është bërë nga administratorët social është parë që gjendja e tyre finaciare është e dobët prandaj janë bërë pjesë e kësaj skeme.

Znj. Antoneta Çunaj

Kush është dakort?

Pro 32 vota

Kundra s'ka

Abstenim s'ka

Të gjithë pro, miratohet.

### **Pika e katërt e rendit të ditës.**

Projekt vendim: “Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve te qeverisjes vendore, Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”.

Znj. Antoneta Çunaj

Të flasi përfaqësuesja e bashkisë.

Znj. Suela Prifti

Ky projekt vendim ka të bëjë për miratimin e një marrëveshje për krijimin e një personi juridik, i cili do të veprojë në formën e një OJF-je, me anëtarësi të përbashkët edhe nga njësítë e qeverisjes vendore edhe nga KM të RSH-së. Qëllimi i kësaj marrëveshje është të rritet kapaciteti i njësive të qeverisjes vendore dhe gjithashtu Bashkia Fier si subjek i kompetencave të përbashkëta të bëhet pjesë e akademisë së trajnimit të njësive të vetqeverisjes vendore të RSH-së. Qëllimi i saj është që personat të cilat janë punonjës pranë njësive të vetqeverisjes vendore, të trajnohen si nga ana profesionale për të qënë sa më koherent dhe për të patur marrëdhënie sa më të mira me qytetarët për tiu përgjigjur kërkeseve të tyre si dhe për të bërë një hap përpara për anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Ky projekt vendim ka si objektiv :


-Krijimin e mundësive për ushtimin e përgjegjësive ligjore të këshillit bashkiak dhe të kryetarit

të bashkisë për zhvillimin dhe kualifikimin profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve,

nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të këshillit të qarkut.

- Zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030.

-Zbatimin e Dokumentit Kombëtar të Politikave dhe të Strategjisë për Administratën Publike.



- Aftësimin e zyrtarëve të bashkisë për të përballuar sfidat dhe kërkesat e procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
- Krijimi i një strukture të dedikuar për aftësimin, kualifikimin profesional dhe trajnimin e zyrtarëve të bashkisë.

Ideja është që nëse miratohet ky projekt vendim, i cili do të përfshijë të gjitha bashkitë e territorit të RSH-së. Është planifikuar dhe përcaktuar një fond i cili në rastin tonë do të merret nga zëri i trajnimeve të planifikuarë për vitin 2025 dhe në vijim do të merret nga buxheti afatmesëm i viteve 2025-2027. Dhe për tre vite është planifikuar që këtë fond do ta mbulojë bashkia.

Z.Melsi Bogdani

Është përcaktuar fondi saktë?

Znj.Suela Prifti

Jo.

Z.Ilia Fili

Zonja kryetare, mund të bëj një pyetje?

Znj. Antoneta Çunaj

Po

Z.Ilia Fili

A bie ky projekt vendim ndesh me kushtetutën dhe me ligjin e vetqeverisjes vendore?

Znj. Antoneta Çunaj


Pse?

Z.Ilia Fili

Sepse në ligjin e vetqeverisjes vendore është përcaktuar saktë dhe qartë se si vepron dhe se si e ushtron aktivitetin e saj vetëqeverisja vendore. Ndërsa në këtë rast po bëjmë një ndryshim të madh, po e kalojmë qeverisjen vendore dhe po e bëjmë bashkë me pushtetin qëndror. Nuk ekziston kjo në ligjin aktual.

Znj.Esmeralda Kapllanaj

Mund të bëj një sqarim? Duke ju referuar ligjit për vetëqeverisjen vendore, sepse normalisht ne si pjesë ekzekutive do ti përmbahemi gjithmonë këtij ligji. Subjekti i ushtrimit të kmpetencave të përbashkëta është i përcaktuar në ligjin e vetëqeverisjes vendore që është organizimi I këtij subjekti në formën e personave juridik, pavarësisht se si do ta marri formën në bazë të dispozitave të kodit civil .Ky ligj nuk e përjashton ligji për vetëqeverisjen vendore që të gjitha njësítë e vetëqeverisjes vendore , bashki apo qarqe, të bashkohen në një person juridik në formën e përcaktuar sipas qëllimit dhe aktit të themelimit të statutit, e keni të përcaktuar në ligjin e vetëqeverisjes vendore që bashkitë , komunat për realizimin e qëllimit dhe funksioneve të tyre, sepse këtu për realizimin e funksioneve të performancës e ke, të rritjes së nivelit dhe të kapaciteteve edhe të të zgjedhurve vendor, edhe të nënpunësve dhe të punonjësve.



Subjekt i kompetencave të përbashkëtave është aty, personi juridic që do të ketë formën e një OFJ-je. E keni të përcaktuar në ligj. Neni 14 pikë 5.

Z.Ilia Fili

Kjo gjë nuk ka qënë në ligjin e mëparshëm.

Znj.Esmeralda Kapllanaj

Është shtuar me ligjin e ri.

Z.Ilia Fili

Pavarësisht ndryshimeve që janë bërë me ligjin e ri, këtu një gjë është e vërtetë, që ky komision i përbashkët është futje duarsh në vendimarrjen e qeverisjes vendore.

Znj.Esmeralda Kapllanaj

Po të shikosh aktin e themelimit, sepse aktmarrëveshja është hapja që i bëhet procesit, se më pas personat juridik kanë organet e tyre drejtuese që i përcaktojnë. Dhe fakti që çdo bashki ka përfaqësuesin e vet dhe çdo qark ka përfaqësuesin, bashkëpunim është ajo por që organizohen në një formë juridike, e ka përcaktuar ligji për vetëqeverisjen vendore si subjekt i kompetencave të përbashkëta, të përbashkëta i kemi funksionet. Sepse ne mund të kemi kompetenca vendore por kemi edhe funksione të deleguara sidomos bashkëpunim ndërinstitucional me pushtetin qëndror.

Znj.Antoneta Çunaj

E hedhim në votim.Kush është dakort?

Pro 28 vota

Kundra 4 vota.

Abstenim s'ka

Miratohet.

### **Pika e pestë e rendit të ditës.**

Projekt vendim: “Për miratimin e kërkesës së shoqërisë “Veko” sh.p.k. për dhënien e të drejtës së kalimit “Për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e linjës nëntokësore së transmetimit të energjisë elektrike” në pronat e Bashkisë Fier”

Znj. Antoneta Çunaj

Komisioni është mbledhur?

Z.Kreshnik Dapi

Komisioni caktoi një datë për mbledhje por nuk u realizua kuorumi, zonja Tavanxhiu dhe unë ishim prezent, në këto kushte nuk u arrit dot një vendimarrje, gjithësesi mbledhja u realizua. Ne biseduan me drejtorët përkatës me Z.Behari dhe Znj.Kapllanaj. Para kësaj unë kam dy kërkesa. Kërkesa e parë është për administratën e bashkisë. Shikoj që mbas dy vitesh punë këtu në këshill, ambjentet për këshillin janë shumë të pakëta dhe juve si kryetare ju kërkoj që ne si këshilltarë të kemi ambjente pune pak më të mëdha duke filluar me zyrën e kryetarit të këshillit, e cila është shumë e vogël për të mbajtur brenda vetes punën e shtatë



komisioneve të përherëshme dhe një komision ad-hoc siç është ai i strehimit. E them këtë sepse mendoj që përveç pengesës teknike që sjell kjo mangësi, mbase ndikon dhe në performancën dhe në psikologjinë e këshilltarëve të cilët duke mos gjetur vënde ku të punojnë, tregohen edhe të painteresuar për vijimin e punës në komisione. Kërkesa e dytë është për këshilltarët, për kolegët e mi. Konkretisht edhe ky komisioni i ekonomisë, pjesën më të madhe të rasteve nuk arrin ti realizojë mbledhjet e tij sepse nuk arrihet kuorumi. Shikoj një mos interesim nga ana e këshilltarëve dhe anëtarëve të këtij komisioni. Dhe këtu i bëj thirrje edhe si koleg, të gjejnë mundësinë të gjejnë kohën brenda angazhimeve të tjera që kanë si në punë dhe në familje, të tregohen të gatshëm sepse e kemi thënë disa herë që puna kryesore në këshill bëhet në komisione.

Znj. Antoneta Çunaj

Fleminderit ! Edhe unë i bashkohem mendimit të këshillitarit për të mos patur pengesa në veprimtarinë e komisioneve.Kush e do fjalën nga administrata në lidhje me pikën pesë të rendit të ditës?

Z.Arbion Behari

Përvendetje! Materiali që ju kemi paraqitur për miratim ka të bëjë me miratimin e kérkesës së shoqërisë VEKO Shpk për lejimin e ndërtimit të linjës nëntokësore të transmetimit në pronat e Bashkisë Fier. Shoqëria VEKO është një shoqëri e cila ka marrë miratimin dhe ka lidhur kontatën me MEI-in për ndërtimin e një parku 2 MË në zonën e Darëzezës. Ka hartuar një projekt për ndërtimin e linjës nëntokësore që lidh parkun me nënstacionin e Darëzezës. Duke qënë se projekti prek një pjesë të pronave të Bashkisë Fier të cilat janë kryesisht rrugë dhe kanale, shoqëria VEKO i është drejtuar me kérkesë Bashkisë Fier për dhënen e të drejtës për ndërtimin , operimin dhe mirëmbajtjen e linjës së transmetimit në pronat e Bashkisë Fier. Bashkia Fier pasi ka kryer verifikimet e nevojshme, ka marrë mendimin dhe nga Drejtoria e Ujitjes dhe e Kullimit për sa i përket pronave kanale, pjesa tjetër e pronave janë rrugë parcelash, ka paraqitur materialin këshillit për miratimin e kérkesës së shoqërisë VEKO për dhënen e të drejtës për ndërtimin , operimin dhe mirëmbajtjen e linjës së transmetimit në pronat e Bashkisë Fier.Në vijim të atyre materialeve që kemi paraqitur edhe për kompanitë e tjera që kanë kërkuar të njëjtën gjë.

Znj. Antoneta Çunaj

A ka ndonjë nga anëtarët e këshillit ndonjë pyetje apo diskutim në lidhje me këtë pikë?

Z.Melsi Bogdani

Këto kalimet nëntokësore prekin prona private?

Z.Arbion Behari

Ne po flasim për miratimin e atyre pronave që janë prona e Bashkisë Fier. Nëse kalon në prona private ai ka marrë miratimin dhe e ka zgjidhur vetë privatisht.


Znj. Antoneta Çunaj

E hedhim në votim.Kush është pro?

Pro 32 vota

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka



Miratohet.

**Pika e gjashtë e rendit të ditës.**

Projekt vendim: “Për dhënien e miratimit për zgjatjen e afatit të kontratave të qirasë nr. 2686 rep. nr. 925 kol. dt. 01.12.2016 dhe kontrata nr. 2824 rep. nr. 954 kol. dt. 15.12.2016, të lidhura ndërmjet Bashkisë Fier dhe subjekteve qiradhënës Arben Haxhi Behaj, Sokrat Dhimitër Jovani dhe Fejzo Beqir Fejzo” të qiramarrjes së pasurisë nr. 8/2 dhe 8/4 zk. 8531 e llojit “truall” me sipërfaqje totale 3 466 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “Kryengritja e Fierit”.

Znj.Antoneta Çunaj

Kush e do fjalën nga administrata?

Z.Arbiion Behari

Përshëndetje! Materiali që ju kemi sjellë për miratim ka të bëjë me miratimin e zgjatjes së afatit të kontratave të qirasë nr. 2686 rep. nr. 925 kol.dt. 01.12.2016 dhe kontrata nr. 2824 rep. nr. 954 kol. dt. 15.12.2016, të lidhura ndërmjet Bashkisë Fier dhe subjekteve qiradhënës Arben Haxhi Behaj, Sokrat Dhimitër Jovani dhe Fejzo Beqir Fejzo” të qiramarrjes së pasurisë nr. 8/2 dhe 8/4 zk. 8531 e llojit “truall” me sipërfaqje totale 3 466 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “Kryengritja e Fierit”. Në këto pasuri është ndërtuar tregu i produkteve bujqësore dhe blektorale përballë QTU-së. Duke qënë se nga drejtoritë që e monitorojnë këtë treg, ajo e bujqësisë dhe ajo e drejtorisë bashkiakë, është konstatuar se numri i tregëtarë që ushtrojnë aktivitetin e shitjes me pakicë të produkteve bujqësore është në rënie dhe numri i tregëtarëve që ushtrojnë aktivitetin e shitjes me shumicë është i lartë. Duke qënë se mjetet e tregëtarëve që kryejnë aktivitetin e shitjes me shumicë parkohen në rrugën përballë tregut, dhe zkonisht bëhen shqetësim për bllokimin e trafikut apo gjatë ushtrimit të aktivitetit në orët e vona të natës bëhen shqetësim për komunitetin përreth, është parë e arsyeshme që të përshtaten ambjentet e këtij tregu në raport 70 % për shitjen e produkteve bujqësore me shumicë dhe me 30% për shitjen e produktet me pakicë në mënyrë që tu shërbejë edhe tregëtarëve me shumicë por që edhe të lirojë trafikun apo zgjidhjen e problematikave me komunitetin. Dhe për këtë qëllim, nga ana e Bashkisë Fier është parë e nevojshme që të kryhen disa investime për përshtatjen e këtyre ambjenteve në raport e përcaktuara më lart.

Z.Melsi Bogdali

Që do të thotë ndarjet bme beton do të prishen?


Kush e do fjalën nga administrata?

Z.Arbiion Behari

Jo nuk do të prishen, do të krijohen hapësira për sistemimin e mjeteve të transportit të cilat sot ata I parkojnë përballë tregut dhe ne duam ti sistemojmë. Duke qënë se ne kontratën e kemi bërë 10- vjeçare dhe kjo kontratë mbaron në dhjetor të 2026 për të kryer këto investime është parë e nevojshme që kjo kontratë të shtyhet edhe me tr evite. Për këtë arsyë i jemi drejtuar këshillit për dhënien e miratimit për shtyrjen e afatit të kontratës.

Z.Melsi Bogdani

Shitja e shpendeëve do të vazhdojë atje?



Z.Arbion Behari

Tani për tani po, më mbas do të gjykohet nëse do të vazhdojë apo jo.

Z.Melsi Bogdani

Për mua tregëtimi i shpendëve nuk duhet të bëhet.

Z.Kreshnik Dali

Edhe për këtë pikë si dhe për pikën parardhëse, sikurse e thashë dhe më parë, komisioni u mblodh për pikën pesë, gjashtë dhe shtatë të rendit të ditës, dhe ja shpreha dhe drejtorit mendimin tim personal që tregu ka dhe një pozicion strategjik që është i favorshëm, si për qytetarët dhe mirë do të ishte të ishte dhe më i madh, por në këto kushte, gjithësesi i vogël nuk është me ato përmasa që ka, një pyetje kam për drejtorin që nuk ja bëra në komision. Keni bërë ndonjë projekt për këto ndërhyrje që doni të bëni në treg, me vlerë financiare përkatëse? Kam dhe një vërejtje për pikën pesë, të cilën ja thashë dhe drejtorit edhe në komision. Duhet të vini në komisione dhe në mbledhje me dokumentacione më të plota, sepse po të ishin ato dhe ne do të ishim të quartë dhe Z.Bogdani nuk do ta bënte atë pyetje.Në eksperiencën time si këshilltar, i vetmi komisioni që të lë pa fjalë dhe që është për tu vlerësuar është Komisioni i Emergjencave Civile dhe drejtori Z.Nasip Bani. Aty kam parë dokumenta autentik, origjinalë për çdo rast. Ne jemi për të ndihmuar punën tuaj sepse jemi qytetarë dhe kemi vendosur të jetojmë këtu së bashku me familjet tonë, prandaj duam që të bëhet më e mira.

Znj.Antoneta Çunaj

E hedhim në votim.Kush është pro?

Pro 32 vota

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka

Miratohet.

### **Pika e shtatë e rendit të ditës.**

Projekt vendim:“ Për kalim vlere nga llogaria 4662104 “Garanci punimesh” të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike në llogarin 7111099 e të ardhurave të Bashkisë Fier”


Znj.Antoneta Çunaj

Dua të sqaroj që emërtesa e pikës shtatë të rendit të ditës nuk është siç është paraqitur në rendin e ditës së publikuar pas mbledhjes së kryesisë por është siç e lexova më lartë për shkak se rendi i ditës nga ana jonë si kryesi miratohet dhjetë ditë para mbledhjes, dhe titulli është përcaktuar në mënyrë përfundimtare nga ana e drejtorisë përkatëse brenda afatit ligjor, pesë ditë para mbledhjes në momentin që ka ardhur dhe ju është paraqitur edhe juve në mënyrë elektronike projekt vendimi përkatës.

Kush e do fjalën?

Znj.Pranvera Cina

Projekt vendimi është mbështetur në kërkesë- relacionin e paraqitur nga ndërrmarja e shërbimeve Publike të Bashkisë Fier, e cila është protokolluar pranë Bashkisë Fier me nr 6062 Prot të datës 21.05.2025, kërkesë për



heqjen nga kontabiliteti të vlerës për garanci punimesh, llogaria 466 dhe kalimin e kësaj vlere në llogarinë e të ardhurave të Bashkisë Fier. Në këtë relacion është shpjeguar dhe është kërkuar heqja nga kontabiliteti i vlerës 32460 lekë . Zyra e financës e ka të pamundur çlirimin e kësaj garancie për mungesë dokumentacioni dhe duke qënë se i takon periudhës së vitit 2014 bazuar në evidencat e thesarit, dhe kërkojmë që kjo vlerë 32460 lekë të kalojë nga 466 garanci punimesh tek llogaria e të ardhurave të Bashkisë Fier.

Znj.Antoneta Çunaj

Kush është pro?

Pro 32 vota

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka

Miratohet.

**Pika e tetë e rendit të ditës.**

Projekt vendim: “Për miratimin e subvencionit të qirasë për familjen e pastrehë, që kërkon të përfitojë nga subvencioni i qirasë në tregun e lirë dhe nuk ka të ardhura për të përballuar vlerën e qirasë”

Znj.Antoneta Çunaj

Kush e do fjalën?

Z.Esmeralda Kapllanaj

Bëhet fjalë për rastin mediatik, për vajzën e dhunuar nga babai të cilës në mbledhjen e kaluar i akorduam ndihmë të menjëherëshme financiare dhe ramë dakort për ti ardhur në ndihmë dhe me subvencionin e qirasë.

Znj.Antoneta Çunaj

Pra sikurse dhe u tha dhe nga drejtoresh përkatëse, ne e kemi trajtuar në mbledhjen e kaluar me ndihmë financierar dhe në këtë mbledhje i akordojmë dhe subvencionin e qirasë.Kush e do fjalën? M.q.s nuk ka diskutime e hedhim në votim.

Pro 32 vota

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

**Pika e nëntë e rendit të ditës.**

Informacion Këshillit : ”Mbi vlerat e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të propozuara dhe vlerësuara nga komisionet përkatëse gjatë kryerjes së inventarizimit 2024, të aparatit të Bashkisë Fier si dhe të disa Njësive Shpenzuese në varësi të Bashkisë Fier.

Znj.Antoneta Çunaj

Pika nëntë e rendit të ditës nuk ka nevojë për miratim është informacion për këshillin.



Me kaq mbledhjen e deklarojë të mbyllur. Ju falenderojë të gjithëve për pjesëmarrjen !

Ky procesverbal ka 10 (dhjetë) faqe dhe mbahet në tre kopje nga ana e Sekretarit të Këshillit Z. Arnando Çupa.

**Sekretar i Këshillit**

**Arnando Çupa**



**Kryetar i Këshillit**

**Antoneta Gunaç**



Këshilltar  
Abey Culco  
  
Mari Gjika  


Këshilltar fëshilltar  
QSSEMA freskuri Lapi  
